



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo  
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial  
Council

KPK/Nr.519/2022  
Datë: 14 prill 2022

Këshilli Prokurorial i Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj prokurorit Musli Gashi, Prokuror në Prokurorinë Themelore në Prizren, në pajtim me nenin 7 paragrafi 1 pika 11 dhe nenit 34 të Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, sipas Raportit të Panelit Hetimor në rastet AD.nr. 06/2021 të datës 04 shkurt 2022 i plotësuar me 18 mars 2022, gjatë shqyrtimit të mbajtur me datë 14 prill 2022, në seancën e këshillimit e votimit mori këtë:

## V E N D I M

- I. **Aprovohet** Raporti i plotësuar i panelit hetimor AD.nr. 06/2021 të datës 18 mars 2022 në rastin disiplinor të prokurorit Musli Gashi, Prokuroria Themelore në Prizren;
- II. **Vërtetohet** se, prokurori Musli Gashi ka vepruar në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve;
- III. Prokurorit Musli Gashi i shqiptohet sanksioni disiplinor, **Vërejtje Publike me shkrim**, sipas nenit 7 paragrafi 1 pika 1.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

## A r s y e t i m

Me datë 06 dhjetor 2021, Këshilli Prokurorial i Kosovës, nga Autoriteti Kompetent ka pranuar propozimin për fillimin e procedurës hetimore disiplinore ndaj Musli Gashi, prokuror në Prokurorinë Themelore në Prizren, duke propozuar të hetohen veprimet e të njëjtit si dhe t'i shqiptohet masa disiplinore Vërejtje publike me shkrim në mbështetje të ligjit të zbatueshëm.

Me datë 28 dhjetor 2021, Këshilli Prokurorial i Kosovës në bazë të nenit 7 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.25 të Ligjit me numër 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenin 12 paragrafi 5 të Ligjit me numër 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të

Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenin 12 të Rregullores me numër 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve nxjerr vendim me numër KPK-Nr.945/2021, për Themelimin e Panelit Hetimor për hetimin e rastit disiplinor AD.nr.06/2021 ndaj Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, z. Musli Gashi.

Me datë 04 shkurt 2022, Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ka pranuar nga Paneli Hetimor, Raportin AD.nr. 06/2021 të cilin, gjatë seancës së shqyrtimit e ka kthyer në plotësim të njëjtit panel hetimor. Me datë 18 mars 2022, KPK ka pranuar nga Paneli Hetimor, Raportin e Plotësuar AD.nr.06/2021 me të cilin, Paneli Hetimor i KPK-së ka ardhur në përfundim se prokurori Musli Gashi, ka vepruar në shkelje të nenit 6 paragrafi 2 pika 2.2 të Ligjit Nr.06/L-057, për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, sepse Prokurori Gashi gjatë shqyrtimit dhe vendosjes së lëndës penale [REDACTED] kishte fshehur disa fakte që kishin ndikim në cilësimin juridik si fakti se, viktimë ishte viktimë e ndjeshme dhe se për shkaktimin e lëndimeve të viktimë ishte përdorur mjeti i fort.

Këshilli Prokurorial i Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datë 14 prill 2022, pasi që ka shqyrtuar raportin e plotësuar nga Paneli Hetimor, ka dëgjuar Raportimin e Kryesuesit të Panelit Hetimor i cili ka elaboruar të gjitha faktet dhe provat e mbledhura gjatë procedurës hetimore. Kryesuesi i Panelit ka përmendur edhe faktin se, gjatë seancës së dëgjimit nga Paneli Hetimor janë bërë disa pyetje për prokurorin Musli Gashi, si e ka marrë në pyetje viktimën si të mitur, që automatikisht e bënë viktimë të ndjeshme dhe është dashur të shënohet në procesverbal për shkak se ndryshon kualifikimi juridik që përfshihet në aktakuzë dhe i njëjti e ka konfirmuar që e ka marrë në pyetje viktimën si të mitur dhe është si provë procesverbali. Në pyetjen a ka pasur mendimin e ekspertit për mjetin që është përdorur për të shkaktuar lëndimet pavarësisht a u gjet mjeti apo jo, i njëjti është deklaruar, po. Në rastin konkret ekziston mendimi i ekspertit edhe kur e kemi pyetur pse nuk e ke përmendur në aktakuzë, subjekti i hetimit ka thënë se nuk jam bindur që ka mundësi të shkaktohet lëndimi me atë mjet të fortë sepse nuk është gjetur mjeti, e sipas panelit hetimor edhe kjo kishte ndikuar në kualifikim juridik sepse përdorimi i mjetit të fortë në rastin konkret përsëri do të ndikonte në kualifikim të drejtë të gjendjes faktike. Kjo ka qenë edhe arsyeja pse është plotësuar raporti i panelit hetimor. Sepse tash nuk kemi më përgjegjësi të subjektit të hetimit për mos zbatim të udhëzimit të Autoritetit kompetent sa i përket cilësimit juridik por kemi shkelje nga neni 6 paragrafi 2 pika 2.2 që e thotë shprehimisht, fshehja e fakteve fajësuese apo shfajësuese. Vet fakti që nuk janë përmendur këto dy fakte në dispozitiv kanë ndikuar që kualifikimi juridik mos me qenë adekuat dhe personi ka mundur të dënohet shumë më pak se sa do të ishte dënuar në bazë të kualifikimit të drejtë. Kjo ka qenë arsyeja pse paneli hetimor e ka gjetur përgjegjës prokurorin Musli Gashi.

Në seancën disiplinore ka prezantuar edhe subjekti i hetimit disiplinor, prokurori Musli Gashi, i cili në mbrojtjen e tij ka deklaruar se, " Unë nuk e kam cek në dispozitiv se viktimë ka qenë e ndjeshme dhe mjetin me të cilin është goditur sepse, policia e forenzikës të cilën e kam autorizuar me dal në vendin e ngjarjes nuk kanë gjetur asgjë. Unë nuk mundem të akuzoj dikë kur nuk kam prova. Unë nuk lejoj akuza ime të dështoj në gjykatë. Nuk është që e kam fshehur që është i mitur, procesverbali është që e kam marrë në pyetje viktimën si të mitur,

*kjo nuk qëndron. Viktima është dëgjuar në cilësinë e të miturit. Unë hetimet i kam filluar për lëndime të rënda por kanë dal lëndime të lehta, mandej e kam ndryshuar veprën në privim të kundërligjshëm me propozim nga autoriteti kompetent, Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren për me gjet një baraspeshë. Rikualifikimin e kam bërë kur Gjykata ka kërkuar. Ndoshta ka qenë lëshimi im që nuk e kam përmend në dispozitiv, por assesi nuk ka qenë qëllimi që unë me fsheh prova. Nuk ka qenë qëllimi im me fsheh prova.”*

Këshilli Prokurorial i Kosovës pas dëgjimit të Kryesuesit të Panelit Hetimor, Subjektit të Hetimit si dhe shqyrtimit, analizimit, krahasimit të provave të cekura në raportin e panelit hetimor, fjalës përfundimtare të Kryesuesit të Panelit Hetimor dhe prokurorit Musli Gashi, erdhi në përfundim se, rasti [REDAKTUAR] është përcjell me lëshime serioze nga prokurori Gashi, me rastin e ngritjes së aktakuzës duke mos e përsi në dispozitiv viktimën e ndjeshme të miturin dhe mjetin e fort jo të prehtë me të cilin është godit viktima e ndjeshme. Nisur edhe nga provat që i ka pasur në dispozicion si mendimin e ekspertit, certifikatën e lindjes së të miturit, pranimin e të pandehurit që e ka goditur me mjet të fort dhe procesverbalin e marrjes në pyetje të miturit, përcaktojnë saktë shkelje në përshkrim të gjendjes faktike në dispozitivin e aktakuzës. Sipas Këshillit Prokurorial të Kosovës, arsyetimi i prokurorit Musli Gashi se, mund të jetë lëshim por i pa qëllimshëm dhe jo fshehje të fakteve, nuk paraqet bazë për të përjashtuar përgjegjësinë disiplinore sepse si prokuror i çështjes ka qenë i detyruar që saktësisht dhe tërësisht t'i konstatoj faktet në aktakuzë e të cilat janë vendimtare për marrjen e një vendimi të ligjshëm dhe të drejtë. Përkundër kërkesës nga Kryeprokurori për t'i evituar gabimet në aktakuzë subjekti i hetimit nuk i bindet kërkesës së eprorit por e bënë përmirësimin vetëm pasi një gjë e kërkon Gjykata duke e kthyer aktakuzën Prokurorisë.

Andaj, për rastin e vërtetuar me shkelje serioze, sanksioni disiplinor **“Vërejtje publike me shkrim”**, është në përputhje me shkeljet e gjetura si në raportin e panelit hetimor, sanksioni i cili do të ketë efekt pozitiv mbi vet prokurorin Musli Gashi që në të ardhmen të veproj sipas rregullave të Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorë.

Nga sa u tha më lart, Këshilli Prokurorial i Kosovës në bazë të vlerësimit të çështjes mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Këshillë Juridike:**

Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese brenda 15 ditëve, pas pranimit të vendimit drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës.

Jetish Maloku  
Kryesues i Këshillit Prokurorial i Kosovës



T'u dërgohet:

- [REDAKTUAR] Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore në Prizren;
- z. Musli Gashi, Prokuror në Prokurorinë Themelore në Prizren;
- Arkivit të KPK-së.